

Policia gjen armë e municion në një kotec pulash në veri të Mitrovicës



04/02/2025 19:26

f

t

o

Policia e Kosovës ka gjetur sot armë e municion në veri të Mitrovicës.

Në komunikatë nga policia thuhet se pas informacioneve se në një lokacion ka armë, njësitet policore kanë ndërmarrë veprimet e menjëhershme ku kanë kryer një kontroll në një lagje afër lumit Ibër, përkatësisht tek "Shkëmbi i Dudës" në qytetin e Mitrovicës Veriore.

Gjatë kontrollit të realizuar në atë pjesë në një kotec pulash policia ka gjetur dhe konfiskuar:

Një armë te gjatë – AK-47,

Dy karikator të së njëjtës armë me nga (tridhjetë) 30 fishek,

Katërqind e shtatëdhjetë e tre (473) fishek të pistoletës,

Dyzet fishek të armës së gjuetisë,

122 fishekë të kalibrave të ndryshëm të armës së gjatë,

Një thikë taktike,

Një komplet i pajisjeve për pastrimin e armës dhe

Një çantë e zezë.

Në lidhje me rastin në Stacion Policor është shoqëruar i dyshuari Z.T. i moshës 68-vjeçare i cili është intervistuar në prezencën e avokatit mbrojtës.

"Të gjitha veprimet e ndërmarra i janë paraqitur Prokurorit të Shtetit i cili ka urdhëruar iniciimin e rastit "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i pa autorizuar të armëve", ndërsa i dyshuari pas intervistimit me urdhër të prokurorit është liruar", thuhet në komunikatë.

LAJME TË FUNDIT

- Haradinaj me paralajmërim të frikshëm: Raportet Kosovë-SHBA janë...
- Suzana Gjekaj, shqiptarja e parë që arrin gradën...
- Hamza: Qeveria aktuale asnjë projekt s'e ka filluar,...
- "Nuk e shohin Kurtin si partner që mund...



Më shumë nga uebi

nativeGRAM

- Gjëegjëza për fëmijë, por që as të rriturit nuk
- Ja cili është kuptimi nëse keni parë ëndërr
- Xud edhe pas spektaklit i nervozuar
- "Familjarja e Kurtit, gruaja e Sali Zylbës",
- A përmban rrezik nëse mbani fëmijët në krahë

Artikuj të ngjashëm



February 4, 2025
Haradinaj me paralajmërim të frikshëm: Raportet Kosovë-SHBA janë në fazë të...



February 4, 2025
Suzana Gjekaj, shqiptarja e parë që arrin gradën Kolonele në Ushtrinë...



February 4, 2025
Hamza: Qeveria aktuale asnjë projekt s'e ka filluar, qytetarët do ta...

Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information